



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KUVENDI**

*Komisioni i Posaçëm për Reformën në Sistemin e Drejtësisë*

**PROCESVERBAL**

Tiranë, më 09.05.2016, ora 10:00

**Drejton mbledhjen:**

**Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit**

**Rendi i ditës:** Votimi në parim i Projektit Kushtetues me reflektimet e Opinionit Final të Komisionit të Venecias dhe komentet e propozimet e bëra nga anëtarët e Komisionit në mbledhjet e mëparshme.

**Marrin pjesë:**

Fatmir Xhafaj, Eduard Halimi, Vasilika Hysi, Ulsi Manja, Pandeli Majko, Petrit Vasili, Oerd Bylykbashi, Arben Ristani, Gent Strazimiri, Fatmir Mediu.

**Mungojnë:** Spartak Braho

**Të ftuar:**

Rainer Deville - Shef i misionit të EURALIUS-it në Shqipëri

Jon Smibert - Përfaqësues i misionit të OPDAT-it në Shqipëri

## HAPET MBLEDHJA

**Fatmir Xhafaj** – Mirëdita! Fillojmë mbledhjen e Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën në Drejtësi. Siç është e njohur, kemi filluar procesin e shqyrtimit të projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”. Javën e kaluar dëgjuam një paraqitje të projektit, i rishikuar nga dy ekspertët e nominuar nga ky komision për të reflektuar rekomandimet e opinionit final të Komisionit të Venecias dhe për të marrë në konsideratë komentet, propozimet e bëra gjatë debatit në këtë komision. Zotërinjtë ekspertë ndërkombëtarë zoti *Rainer Deville* dhe zoti *Jon Smibert* kanë bërë një paraqitje të ndërhyrjeve që janë bërë në tekstin e projektligjit. Të gjithë jeni njohur tashmë me tekstin e rishikuar ku janë bërë reflektimet përkatëse. Sot është momenti, ashtu siç edhe kemi rënë dakord, për të bërë pyetje, nëse do të ketë, megjithëse janë bërë pyetje gjatë gjithë këtyre seancave pa mbarim në muajt mars, prill, gjithsesi, kjo është një e drejtë procedurale; për të diskutuar në parim, por edhe diskutime në parim janë bërë shumë, por mund të vazhdojmë edhe sot, nëse ka, dhe në përmbyllje do të jetë votimi në parim i draftit të paraqitur.

A ka pyetje? Nuk ka.

A ka diskutime në parim?

Fjalën e ka zoti Halimi.

**Eduard Halimi** – Përshëndetje të gjithëve!

Sigurisht, ne kemi përmbyllur deri më sot diskutimin e çështjeve politike; kemi rënë dakord për komponentin antikorrupsion dhe për çështje teknike, të cilat ua kemi adresuar ekspertëve për t’i zgjidhur, si dhe nuk kemi rënë dakord për çështjet politike, siç është çështja e skemës së institucionale, e emërimeve të institucioneve të reja me 3/5, siç është propozuar në fillim që në draftin e shtatorit dhe që ekspertët EURALIUS-it dhe të OPDAT-it në dokumentin e tyre që paraqitën në datën 4 maj 2016 shprehen se për çështjet politike ata nuk kanë bërë ndërhyrje dhe kjo është një çështje, për të cilën, ashtu siç thotë edhe Komisioni i Venecias, duhet të vazhdojnë diskutimet.

Në datën 4 maj, në vijim të detyrës së lënë nga ne, ekspertët e misioneve ndërkombëtare të EURALIUS-it dhe të OPDAT-it paraqitën për herë të parë në mbledhjen e komisionit një version të rishikuar të amendamenteve kushtetuese. Që në fillim të këtij dokumenti evidentohet se ndryshimet e paraqitura nga ekspertët bazohen në:

1. në përmbushjen e opinioneve të Komisionit të Venecias, në veçanti në opinionin përfundimtar të datës 15 mars 2016 (nr. 824/2015);
2. në vendimet politike të marra nga Komisioni i Posaçëm i Reformës në Drejtësi;
3. në marrjen në konsideratë të shqetësimeve politike, që lidhen me disa institucione të veçanta, dhe në ofrimin e opsioneve (shënuar me ngjyrë blu);
4. në synimin për të harmonizuar tekstin, ose kryerjen e ndërhyrjeve teknike në projektligj, që rrjedhin drejtpërsëdrejti nga reflektimi i propozimeve dhe i rekomandimeve të Komisionit të Venecias.

Theksoj se ekspertët kanë shprehur qartësisht në hyrje të draftit pozicionin se propozimet e tyre nuk përfshijnë asnjë vendimmarrje politike që pritet të arrihet ndërmjet palëve dhe nuk kanë synim të kërkojnë përzgjedhjen apo favorizimin e një vendimi politik kundrejt një tjetri. Kjo është edhe arsyeja përse në këtë draft nuk kanë marrë ende adresim disa shqetësime politike të pranuar të opozitës parlamentare (dispozitat kanë mbetur të pandryshuara në këtë drejtim nga shtatori i vitit 2015, sepse pozicioni i drejtë i ekspertëve ndërkombëtar, bazuar në opinionin final të Komisionit të Venecias, është se për to duhet të ketë diskutim dhe vendimmarrje në nivel politik dhe jo teknik).

Ne, anëtarët e opozitës në Komisionin e Posaçëm, shprehim mirënjohjen dhe falënderimin për angazhimin profesional të ekspertëve të EURALIUS-it dhe të OPDAT-it dhe për ndihmën e ofruan në përmbushjen e detyrës që na ka ngarkuar Kuvendi i Shqipërisë për hartimin e një pakete të plotë projektligjesh të nevojshme për reformimin e legjislationit, që rregullon organizimin dhe funksionimin e institucioneve të sistemit të drejtësisë, duke përfshirë ato kushtetuese.

Nga analiza në tërësi e draftit të rishikuar nga ekspertët e EURALIUS-it dhe të OPDAT-it, ne konstatojmë përmirësime, të cilat synojnë përafrimin e tij me standardet ndërkombëtare, duke përmbushur në këtë mënyrë një kërkesë themelore të opozitës parlamentare. Është botërisht e ditur se draftet e njëanshme të shtatorit 2015 dhe të janarit 2016 paraqisnin problematika të thella mbi përputhshmërinë e tyre me standardet ndërkombëtare, të cilat u konfirmuan nga Komisioni i Venecias dhe nga ndryshimet që kanë propozuar ekspertët e EURALIUS-it dhe të OPDAT-it.

Ndryshimet që i janë bërë draftit në versionin e datës 4 maj 2016 janë kërkuar nga ne që të kryheshin që në shtator të vitit 2015, konfirmuar me qëndrimet e ekspertëve dhe të anëtarëve

të komisionit edhe ndërkombëtarisht, mirëpo, maxhoranca parlamentare këmbënguli për të vijuar punën në mënyrë të njëanshme.

Ne jemi të bindur se thelbi i reformës në drejtësi, i asaj çfarë presin prej nesh qytetarët, është lufta ndaj korrupsionit në sistemin e drejtësisë, largimi i gjyqtarëve e prokurorëve të korruptuar dhe të paaftë, ngritja e një sistemi eficient të hetimit penal për të përballur me ligjin të gjithë zyrtarët e nivelit të lartë dhe për t'i dhënë fund pandërshkueshmërisë. Ndaj, në shtator të vitit 2015 ne kemi mbështetur në parim komponentin antikorrupsion të paketës së ndryshimeve kushtetuese, duke ngritur si shqetësim të vetëm për këtë komponent kapjen politike dhe garantimin e standardeve europiane sipas Konventës Europiane të Drejtave të Njeriut në këtë proces. Gjithashtu, ne e kemi cilësuar si të papranueshme ngritjen e Byrosë Kombëtare nën qeverinë, mosgarantimin e statusit të prokurorëve të posaçëm, si dhe kontrollin e plotë politik të komisioneve të veting-ut. Këto shqetësime janë pranuar në të dyja opinionet e Komisionit të Venecias.

Në draftin e rishikuar, në komponentin antikorrupsion (nenin 25), është parashikuar se subjekt i hetimit do të jenë, ndër të tjerë, ish-ministrat e 3 vjetëve të fundit. Duam të theksojmë fort se kjo pikë nuk është kërkuar asnjëherë, as nga ekspertët e opozitës dhe as nga ndonjë anëtar i opozitës në komision. Ne e kemi shprehur dhe e ripërsërisim qëndrimin tonë për luftë pa kompromis ndaj korrupsionit dhe se kemi qenë, jemi dhe do të jemi kundër çdo kufizimi kohor për hetimin e zyrtarëve dhe të ish-zyrtarëve, sepse korrupsioni duhet të dënohet, pavarësisht kur apo nga kush është kryer.

Lidhur me komponentin tjetër, atë të skemës së re institucionale, opozita ka ngritur që në shtator të vitit 2015 dy shqetësime kryesore: mungesën e zbatimit të parimit të kontrollit e balancës mes pushteteve dhe luftën ndaj korporatizmit, si dhe kapjen politike të këtyre institucioneve, duke parashikuar emërimin e të gjithë funksionarëve me votat vetëm të maxhorancës aktuale parlamentare (84 vota).

Dafti i 4 majit vjen si një produkt i këtyre përpjekjeve të ekspertëve të opozitës, të cilët me profesionalizëm dhe me racionalitet arritën ta bindnin Komisionin e Venecias dhe ekspertët ndërkombëtarë për të ndryshuar pozitivisht draftin dhe për ta sjellë atë, në pjesën dërrmuese, sipas standardeve euroatlantike.

Konkretisht, sipas opozitës, krahasuar me draftet e njëanshme të maxhorancës parlamentare të shtatorit të vitit 2015 dhe të janarit të vitit 2016, në versionin e fundit janë bërë disa përmirësime, të cilat janë:

A. Për komponentin antikorrupsion:

1. Është qartësuar pavarësia nga politika e Prokurorisë së Posaçme Antikorrupsion (SPAK), duke parashikuar procedurat e emërimit të prokurorëve të posaçëm dhe drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, si dhe shkarkimin e tyre po nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë me shumicë të cilësuar.

2. I është dhënë fund çdo përpjekjeje për ta pasur Njësinë e Posaçme Hetimore (BKH-në) nën varësinë e qeverisë, pra të Ministrisë së Brendshme. Gjithashtu, është parashikuar që Njësia e Posaçme Hetimore, e cila do të raportojë vetëm te Prokuroria e Posaçme, duhet të jetë tërësisht pjesë e këtij institucioni.

3. Është hequr roli i Kryeministrit në emërimin e vëzhguesve ndërkombëtarë.

4. Është rishikuar dhe është zvogëluar roli i Avokatit të Popullit në procesin e emërimit të anëtarëve të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe Kolegjit të Posaçëm pranë Gjykatës së Lartë.

5. Është qartësuar modeli i organizimit të prokurorisë.

6. Janë parashikuar shprehimisht rastet e shkarkimit të prokurorëve nga detyra.

7. Është hequr mundësia e ndërprerjes së pajustificuar ligjërisht të mandatit të Prokurorit të Përgjithshëm.

8. Është parashikuar shkurtimi i mandatit të veprimtarisë së Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (5 vjet) dhe Kolegjit të Posaçëm në (9 vjet), i cili kërkon që të shoqërohet edhe mundësia për shkurtim të mëtejshëm.

9. Është përmirësuar ndjeshëm procesi i rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve, në funksion të mbrojtjes së përshtatshme për gjyqtarët dhe prokurorët e ndershëm.

10. Është parashikuar shprehimisht që kufizimi i të drejtave të gjyqtarëve dhe prokurorëve të bëhet vetëm në masën që e lejon zbatimin e procesit të rivlerësimit dhe jo apriori.

11. Është parashikuar krijimi i Këshillit Përzgjedhës për kandidaturat për anëtarë të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe Kolegjit të Posaçëm të Gjykatës Kushtetuese, ide e cila kërkon të elaborohet dhe të përmirësohet edhe më tej.

12. Është qartësuar se barra e provës për gjyqtarët dhe prokurorët në vlerësim vlen vetëm për këtë proces dhe jo për ndonjë proces të mundshëm penal, që mund të ndiqet në të ardhmen si pasojë e të dhënave të procesit të vlerësimit.

B. Për komponentin e institucioneve të përhershme:

1. Është çmontuar tentativa për kontrollin politik të sistemit të drejtësisë, duke hequr rolin e qeverisë, e ministrit të Drejtësisë, në mbledhjet e KLGJ-së dhe të KLP-së, si dhe e drejta për të kërkuar fillimin automatik të hetimit të shkeljeve disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

2. Është çmontuar tentativa për kontrollin politik të sistemit të drejtësisë, duke hequr rolin e qeverisë, e ministrit të Drejtësisë, në veprimtarinë e Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë, i cili merrte pjesë si vëzhgues në mbledhje, si dhe e drejta për të kërkuar fillimin automatik të hetimit të shkeljeve disiplinore të gjyqtarëve dhe të prokurorëve.

3. Është çmontuar tentativa për kontrollin politik të sistemit të drejtësisë, duke hequr kompetencën e qeverisë, të ministrit të Drejtësisë, për të kontrolluar punën e Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë.

4. Është parashikuar mundësia e ankimit të vendimit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për mosfillimin e hetimit apo pushimin e procedimit ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve.

5. Është bërë një përpjekje për të mundësuar një kontrolli të jashtëm të balancuar ndaj inspektorit të lartë të drejtësisë, i cili ka nevojë të shqyrtohet më nga afër.

6. Është zhveshur drafti nga përcaktimi i kriterëve selektive në institucione të ndryshme të sistemit të drejtësisë, që synonte paracaktimin e funksionarëve dhe emërimin në këto funksione të juristëve të periudhës së komunizmit.

7. Është ndryshuar përbërja politike e Tribunalit Disiplinor të Drejtësisë, ku parashikohej më parë të kishte rol edhe qeveria (ministri i Drejtësisë).

8. Është ndryshuar përbërja politike e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, ku më parë parashikohej të kishte rol edhe qeveria, pra ministri i Drejtësisë, si dhe janë hequr kriteret e paracaktimit të anëtarëve të rinj, që i jepte përbërjes së KED-së tiparet e një organi me listë emërore të bashkëlidhur.

9. Është qartësuar roli pa të drejtë vote i ministrit të Drejtësisë në mbledhjet e KLGJ-së dhe të KLP-së, ku do të diskutohen çështjet buxhetore dhe planifikimi strategjik.

10. Është parashikuar shprehimisht mënyra e zgjedhjes së gjyqtarëve të Gjykatës së Posaçme dhe shkarkimi i tyre me shumicë të cilësuar nga KLGJ-ja.

11. Është bërë përpjekje për të qartësuar rrethin e funksionarëve që përfshihen nën fushën e kompetencës së gjykatave të posaçme (duke përfshirë këtu edhe komentën e bërë në fillim të kësaj fjale).

12. Është parashikuar shprehimisht se gjyqtarë dhe prokurorë në Republikën e Shqipërisë mund të bëhen vetëm shtetasit që kanë përfunduar Shkollën e Magjistraturës.

13. Është parashikuar mundësia e krijimit të nënkomiteteve brenda KLGj-së dhe KLP-së.

14. Janë qartësuar procedurat dhe kriteret e emërimit të anëtarëve gjyqtarë dhe prokurorë të KLGj-së dhe të KLP-së.

15. Është bërë përpjekje për zgjedhjen me shumicë të cilësuar nga Kuvendi i anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese.

16. Janë përmirësuar procedurat dhe kriteret e emërimit të anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese.

17. Është qartësuar imuniteti i anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese dhe procedura disiplinore ndaj tyre.

18. Janë përmirësuar rregullat për vazhdimin e qëndrimit në detyrë të anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese, që u ka përfunduar mandati.

19. Janë parashikuar rastet e pezullimit nga detyra të anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese.

20. Janë qartësuar rastet e papajtueshmërisë në detyrë të anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese dhe të gjithë funksionarëve të sistemit të drejtësisë.

21. Është detajuar mënyra e zgjedhjes së kryetarit të Gjykatës Kushtetuese, të Gjykatës së Lartë dhe të Gjykatës së Lartë Administrative .

22. Është ngushtuar rrethi i rasteve për të cilat parashikohet mundësia e moslejimit të ankimit në një gjykatë më të lartë.

23. Është zgjidhur situata e mosmarrëveshjes së kompetencave midis Gjykatës së lartë dhe Gjykatës së Lartë Administrative.

Ne përshëndesim dhe mbështesim pa asnjë mëdyshje ndërhyrjet përmirësuese që ekspertët e EURALIUS-it dhe të OPDAT-it kanë bërë në draftin e ri. Rregullimi i të gjitha problematikave të mësipërme, si dhe ndryshimet e tjera teknike që ka pësuar drafti, të cilat janë

kërkuar me shkrim nga opozita parlamentare që në shtator të vitit 2015, nuk përbëjnë pa asnjë dyshim “tërheqje” të mazhorancës për të “kënaqur” kërkesat e opozitës. Ato janë dhe mbeten vetëm reflektim i pjesshëm i domosdoshmërisë për të çmontuar përpjekjet e mazhorancës për një reformë në drejtësi në kundërshtim me standardet ndërkombëtare, dhe tentativat e qarta për të kontrolluar dhe për të çimentuar kapjen politike të sistemit të drejtësisë në të ardhmen.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Është dokument parlamentar dhe duhet të lexohet. Aktualisht, mbeten ende disa çështje që kërkojnë zgjidhje politike, për të cilat ekspertët e EURALIUS-it dhe të OPDAT-it janë shprehur qartë se, për sa kohë nuk ka një vendimmarrje politike lidhur me to, ata nuk mund të bëjnë ndërhyrje në draft. Në fakt, çështjet që kërkojnë vendimmarrje politike janë evidentuar edhe nga Komisioni i Venecias në opinionin e tij final dhe për të cilat duhet të vendosim ne, anëtarët e Komisionit të Posaçëm Parlamentar, me qëllim finalizimin sa më parë të këtij procesi në përputhje me standardet ndërkombëtare nëpërmjet dialogut të sinqertë politik.

Gjithashtu, drafti paraqet edhe disa probleme teknike, të cilat janë evidentuar në mënyrë të plotë nga ana jonë, por për të cilat do të shprehem në diskutimet e thelluara që do t’u bëhen amendamenteve me qëllim arritjen e synimit të punës së Komisionit të Posaçëm për përmirësimin e mëtejshëm të përmbajtjes së draftit. Në fakt, ekzistencën e disa problemeve teknike e ka konstatuar edhe Komisioni i Venecias në opinionin final, ku është shprehur: “Mbeten disa probleme teknike, por që nuk duhet të jenë të pazgjidhshme. Ky opinion nuk analizon me detaje tekstin e rishikuar, por trajton çështjet kyçe të mbetura që duket se kanë qenë më të debatuar në diskutimin e brendshëm politik (paragrafi 8)”. Edhe ne vlerësojmë se problemet teknike të evidentuara nuk duken të jenë të pazgjidhshme.

Në këtë drejtim, gjejmë rastin t’u kërkoj kolegëve të mazhorancës në komision vullnet të sinqertë politik dhe profesionalizëm për të trajtuar dhe për të gjetur zgjidhje sa më parë për çështjet që mbeten ende të pazgjidhura dhe për të cilat ekspertët ndërkombëtarë presin vendimmarrje politike nga ne, me qëllim adresimin e tyre në draftin e rishikuar të amendamenteve kushtetuese. Në veçanti, përpara nesh shtrohen për vendimmarrje politike dy çështje themelore, të cilat nuk kanë gjetur ende pasqyrim në draftin e rishikuar të amendamenteve kushtetuese, që kanë të bëjnë me garantimin e moskapjes politike të sistemit të drejtësisë, si dhe me luftën ndaj korporatizmit në drejtësi.



1. Për përgjegjshmërinë dhe luftën ndaj korporatizmit në sistemin e drejtësisë, ne kemi shprehur shqetësimin për skemën organizative që propozojnë amendamentet kushtetuese. Edhe kjo çështje kërkon vendimmarrje politike, bazuar edhe në konstatimin e Komisionit të Venecias në opinionin final, ku specifikohet: “Në përfundim i takon ligjvënësit kombëtar që të hartojë sistemin e kontroleve dhe të ekuilibrave (paragrafi 11 i opinionit final)”. Për opozitën parlamentare kjo çështje është më shumë me karakter sistematik dhe funksional, që lidhet me funksionimin afatgjatë të sistemit, se çështje politike. Prandaj, besojmë se diskutimet tona të përbashkëta për këtë çështje në komision duhet të jenë të zhveshura nga konsiderata, ndarje apo emocione politike.

Në këtë kuadër, dëshirojmë vëmendjen tuaj për skemën që ofrojnë amendamentet kushtetuese, për të gjykuar me ftohtësinë e nevojshme profesionale nëse kjo është zgjidhja dhe modeli më i mirë i mundshëm që mund të adoptohet nga ana jonë dhe do t'i shërbejë Shqipërisë në dekadat e ardhshme. Sipas amendamenteve kushtetuese krijohen 4 organe, Këshilli i Lartë Gjyqësor, Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Inspektori i Lartë i Drejtësisë dhe Tribunali Disiplinor, të cilat do të merren me emërimin, me promovimin, me disiplinimin dhe me shkarkimin e gjyqtarëve. Mirëpo, konstatohet lehtësisht se marrëdhënia institucionale dhe funksionale midis tyre shoqërohet me konflikt të dukshëm interesi, që kontribuon në forcimin e korporatizmit dhe në mungesën e përgjegjshmërisë dhe llogaridhënies.

Konkretisht, marrëdhënia ndërmjet Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë prezanton konflikt interesi. Inspektori i Lartë i Drejtësisë inspekton gjyqtarët, por, njëkohësisht, inspekton edhe anëtarët e KLGJ-së, të cilët presupozohet të jenë të paanshëm dhe të painfluencueshëm gjatë vendimmarrjes disiplinore për kërkesën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për procedim të gjyqtarëve. Kjo do të thotë që, praktikisht, Këshilli i Lartë Gjyqësor në procedimet disiplinore nuk është i paanshëm as në dukje e as në thelb. Ata do të kontrollohen nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, ndërkohë do të jenë edhe gjyqtarë në kuptimin e gjykimit administrativ, në rastin kur ILD-ja do të bëjë procedimin disiplinor. Ky është një nga problemet thelbësore të skemës së re institucionale të propozuar. Standardet europiane ua njohin të drejtën e garantimit të statusit dhe të ndëshkimit të shkeljeve të bëra nga gjyqtarët vetë organeve që merren me organizimin e sistemit gjyqësor, pra KLGJ-së apo KLP-së. Kjo e fundit e strukturuar në nënkomisione (modele të ndryshme të vendeve të Bashkimit Europian) është në gjendje të angazhohet jo vetëm në vendimmarrje, por edhe në hetimin e shkeljeve të gjyqtarëve. Me këtë

skemë ruhet edhe parimi i vetërregullimit të sistemit, edhe parimi i paanshmërisë së KLGJ në vendimmarrje, edhe parimi i llogaridhënies së KLGJ, e cila i nënshtrohet një kontrolli të jashtëm në veprimtarinë e saj, por ka në përbërje edhe 5 anëtarë të jashtëm, që vijnë nga parlamenti.

Akoma më i rëndësishëm është konflikti apo korporatizmi midis Inspektorit të Drejtësisë dhe Tribunalit Disiplinor, sipas të cilit Tribunali Disiplinor është i përbërë nga gjyqtarë dhe prokurorë, të cilët hetohen nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, atëherë çështjet e inspektuara nga i Inspektori Lartë i Drejtësisë dhe të prezantuara para Tribunalit Disiplinor për vendimmarrje, i nënshtrohen një procesi defektoz, sepse gjyqtarët dhe prokurorët e Tribunalit, subjekt hetimi nga Inspektori, nuk mund të jenë kurrësi të paanshëm dhe të painfluencueshëm prej këtij organi, aq më tepër kur gjyqtarët dhe prokurorët, që janë subjekt hetimi nga ILD-ja, do të luajnë edhe rolin e gjykatës për shkeljet disiplinore të Inspektorit. Është pikërisht kompetenca e Inspektorit për inspektimin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve zanafilla e konfliktit të interesit që mbartet tek institucionet e tjera që përbëhen nga gjyqtarë dhe nga prokurorë, siç janë Këshilli i Lartë Gjyqësor, Këshilli i Lartë i Prokurorisë dhe Tribunali Disiplinor. Kjo për faktin se një gjyqtar apo prokuror nuk mund të jetë njëkohësisht edhe “i hetuar” edhe “vendimmarrës”, përballë “hetuesit” të vet. Kjo situatë duhet shmangur, sepse kompromenton të gjithë qëllimin për shmangien e korporatizmit dhe krijimin e një mekanizmi llogaridhënës efektiv.

Nga ana tjetër, sipas skemës së propozuar, Tribunali Disiplinor për gjyqtarët dhe prokurorët vendos në lidhje me masat disiplinore për anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor, e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, për Prokurorin e Përgjithshëm dhe për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë. Mekanizmi, sipas të cilit Tribunali Disiplinor dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor shqyrtojnë çështjet e njëra-tjetrës reciprokisht, pra një gjyqtar anëtar i Tribunalit i nënshtrohet KLGJ-së në procedimin disiplinor, kurse një anëtar i KLGJ-së i nënshtrohet procedimit disiplinor prej Tribunalit Disiplinor ka premisë të madhe për korporatizëm, sepse anëtarët respektivë mund të krijojnë pakte të heshtura mossulmimi ndaj njëri-tjetrit. Po kështu, marrëdhënia midis Tribunalit dhe Inspektorit është korporatiste, sepse shqyrtojnë çështjet e njëri-tjetrit. Inspektori i Lartë i Drejtësisë i nënshtrohet vendimmarrjes disiplinore, sepse e shkarkon Tribunali Disiplinor, kurse gjyqtarët anëtarë të Tribunalit Disiplinor i nënshtrohen inspektimit disiplinor, pra unë të kontrolloj, ti më shkarkon. Pra, kjo situatë mund të krijojë pakte mossulmimi reciprok dhe duhet të rishikohet nga afër edhe gjatë diskutimeve nen për nen që do të bëjmë ditë në vijim.

Për sa më lart, vlerësojmë se krijohet një situatë korporatizmi e pastër, e cila ka potencial të jashtëzakonshëm që ta bëjë sistemin të mbyllur dhe të krijojë kështu premisa edhe më të mëdha për mungesë llogaridhënie të sistemit gjyqësor, ndoshta edhe më keq se është sot. Ky është ndoshta defekti dhe shqetësimi më i madh i opozitës për skemën e re institucionale, e cila kërkon një shqyrtim të kujdesshëm dhe profesional nga ana jonë, për të cilën përfaqësuesit tanë janë të gatshëm ta diskutojnë pa asnjë ngarkesë politike.

2. Për çështjen e moskapjes politike të sistemit të drejtësisë, e cila është më së shumti çështje politike se teknike, zgjidhja e mbrojtur nga mazhoranca për emërimin e të gjithë funksionarëve të lartë të sistemit të drejtësisë (anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese, Prokurorit të Përgjithshëm, Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, 5 anëtarëve të jashtëm të KLGJ-së dhe KLP-së, anëtarëve të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe anëtarëve të Kolegjit të Posaçëm të Kualifikimit me 3/5 e votave, që zotërohen prej saj aktualisht në Kuvend) ka qenë dhe mbetet e papranueshme për ne. Për këtë çështje, Komisioni i Venecias në opinionin final ka bërë të qartë:

“Në lidhje me metodën e zgjedhjes së anëtarëve jo-gjyqtarë, janë të mundshme disa zgjidhje të tjera dhe parlamenti mund të konsiderojë edhe alternativa të mëtejshme, përkatësisht, duke siguruar përfaqësimin proporcional de facto të forcave kryesore politike brenda KLGJ-së. Komisioni i Venecias thekson se i takon ligjbërësit vendas që të përzgjedhë sistemin që, së pari, do të sigurojë përzgjedhjen paraprake të kandidatëve më të kualifikuar nga një trupë e përshtatshme ekspertësh dhe, së dyti, do t'i japë opozitës mundësinë që të ndikojë në zgjedhjen e pjesës jo-gjyqtarë të KLGJ-së nëpërmjet kërkesës për shumicë të cilësuar ose në ndonjë mënyrë tjetër (paragrafi 17)”. Të njëjtën gjë bëjnë edhe paragrafët 21, 25, 61 dhe 88 për organet e tjera.

Nga ana tjetër, misionet ndërkombëtare kanë kërkuar nga opozita parlamentare mbështetjen e njërës prej formulave: Vendi i rezervuar apo votë e transferueshme.

3. Opozita parlamentare, që përpara se bëhej i njohur opinionin final i Komisionit të Venecias për këtë çështje, bazuar në standardet ndërkombëtare, ka konfirmuar qëndrimin e saj në datën 17 shkurt 2016 se pranon njërin prej modeleve të propozuara nga ekspertët ndërkombëtarë të EURALIUS-it dhe të OPDAT-it në datën 10 shkurt 2016, të sugjeruara më vonë edhe nga Komisioni i Venecias. Fakti që ky model i propozuar nga ekspertët e EURALIUS-it dhe të OPDAT-it është pranuar nga ne, konfirmohet edhe në materialin që ekspertët e këtyre misionëve u kanë dërguar më 20 prill 2016 ekspertëve të Partisë Demokratike, ku konfirmohet se, tashmë, i takon vendimmarrjes politike të përzgjedhë modelin e duhur dhe se ato nuk do të bëjnë asnjë

rekomandim tjetër për modelin e emërimit të funksionarëve të sistemit. Për këtë qëllim, ne kemi hedhur hapin tonë në drejtim të gjetjes së formulës që zgjidh këtë çështje, bazuar në opinionin e Komisionit të Venecias, ku në paragrafin 17 sugjerohet modeli i vendeve të rezervuara si zgjidhje e mundshme e problematikës. I mbetet mazhorancës, tashmë, që të pranojë zbatimin e opinionit të Komisionit të Venecias dhe modelin e propozuar nga ekspertët ndërkombëtarë.

Nga ana tjetër, parashikimi për rekrutimin në masë në sistemin gjyqësor të kategorive të paracaktuara të individëve jashtë Shkollës së Magjistraturës (të këshilltarëve ligjorë pranë Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë, të ndihmësve ligjorë pranë gjykatave administrative si dhe të ndihmësve ligjorë pranë Prokurorisë të Përgjithshme, të ish-gjyqtarëve ose të ish-prokurorëve dhe ish- këshilltarëve ligjor të Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë, të cilët kanë të paktën tre vjet) sjell për ne me vete riskun e lartë për politizimin e sistemit të drejtësisë në vend. Ky është një debat të cilin ne e kemi bërë që në krijimin e Shkollës së Magjistraturës, këtu e 20 vjet më parë, dhe mbetemi koherentë në qëndrimin tonë se nuk jemi gati të pranojmë asnjë alternativë, e cila do të futë në sistemi gjyqësor njerëz që nuk vijnë nga Shkolla e Magjistraturës, pra që do të futen nga dritarja dhe jo nga dera, siç është aktualisht sistemi.

Gjithashtu, në kuadër të diskutimeve tona në nivel parimor për draftamendamentet kushtetuese, dëshirojmë të sjellim në vëmendjen tuaj edhe një çështje tjetër, e cila kërkon një analizë të kujdesshme. Sipas dispozitave tranzitore, organet e reja KLGJ-ja dhe KLP-ja ngrihen dhe fillojnë funksionimin brenda 8 muajve nga hyrja në fuqi e ligjit. Nga ana tjetër, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ngrihet dhe fillon funksionimin brenda tre muajve nga hyrja në fuqi e ligjit. Fillimi i funksionimit të KLGJ-së shoqërohet edhe me ndërprerjen e mandatit kushtetues të Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

Paraprakisht, dëshirojmë të theksojmë se opozita parlamentare është në favor të ruajtjes së mandatit kushtetues të të gjitha organeve kushtetuese, funksionarët e të cilëve kalojnë me sukses procesin e rivlerësimit. Ndërprerja e mandatit kushtetues të tyre, brenda tetë muajve nga hyrja në fuqi e ligjit, krijon edhe një problem tjetër që duhet të trajtohet me hollësi edhe gjatë diskutimeve nen për nen.

Në këtë pikë sjellim në vëmendjen tuaj se asnjë nga organet e reja të sistemit të drejtësisë nuk mund ta fillojë funksionimin, pa iu nënshtruar fillimisht procesit të rivlerësimit secili prej anëtarëve të këtyre organeve.

Realizimi i procesit të rivlerësimit për anëtarët e rinj të organeve kushtetuese do të kërkonte domosdoshmërisht fillimin nga funksionimi të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe Kolegjit të Posaçëm të Kualifikimit pranë Gjykatës Kushtetuese. Edhe anëtarët e këtyre dy strukturave të fundit duhet t'i nënshtrohen procesit të rivlerësimit.

Në përfundim, mendojmë se fillimi nga funksionimi i KLGj-së, KLP-së dhe ILD-së duhet të ketë në konsideratë nevojën për mungesën e çdo dyshimi mbi integritetin e zyrtarëve të rinj. Gjithashtu, është e nevojshme që të respektohen kompetencat kushtetuese të Presidentit të Republikës deri në fund të mandatit të tij kushtetues.

4. Një tjetër çështje që, në fakt, nuk është e lidhur drejtpërdrejt me nevojën e rishikimit të Kushtetutës në kuadër të reformës në drejtësi është edhe ndryshimi i propozuar në nenin 6/1 të Kushtetutës aktuale, që ka të bëjë me reformën e dekriminalizimit. Kjo dispozitë kushtetuese është dakordësuar ndërmjet palëve politike vetëm katër muaj më parë, për pasojë për ne as që mund të merret në konsideratë mundësia e rishikimit të saj apo e ridiskutimit të përmbajtjes së kësaj dispozite kushtetuese. Nëse maxhoranca është penduar për dhënien e konsensusit të detyruar nga faktori ndërkombëtar për reformën e dekriminalizimit, atëherë duhet ta kërkojë hapjen e një diskutimi të posaçëm me fokus vetëm për këtë çështje dhe jo ta përfshijë atë në procesin e reformës në drejtësi.

Për ta konkluduar konsideratën tonë të përgjithshme për draftamendamentet Kushtetuese, duke mbajtur parasysh sa më sipër, në emër të anëtarëve të opozitës parlamentare, shprehim vlerësimin për përmirësimet e bëra nga ekspertët e EURALIUS-it dhe të OPDAT-it, si dhe kërkesën për të nisur menjëherë diskutimin nën për nen që do të çojë drejt vendimmarrjes politike me qëllim konsensusin e plotë politik për draftin e amendamenteve kushtetuese dhe nisjen e punës për paketën e ligjeve shoqëruese, në zbatim të detyrës që na është ngarkuar ne si komision, në mënyrë që në fund të miratimit në tërësi të miratohet edhe paketa ligjore, që do të shoqërojë implementimin e komponentit antikorrupsion, apo edhe ligje të tjera, të cilat ne i kemi diskutuar në mbledhjet e tjera.

Në këtë drejtim, propozimi i kryetarit për një votim në parim për ne është një procedurë ekstra kushtetuese dhe parlamentare.

Ajo që mendojmë se duhet të ndodhë nga sot e në vijim është vendimmarrja politike, pra shprehja e vullnetit politik që ne të gjithë biem dakord për të ecur me diskutimin nën për nen të amendamenteve kushtetuese. Për çështjet, për të cilat nuk kemi rënë dakord, duhet të vazhdojë

diskutimi politik. Paralelisht, duhet të nisë dhe të përfundojë puna për paketën e plotë ligjore që do të shoqërojë amendamentet kushtetuese.

Ky konstatim sillet në vëmendjen tuaj për faktin se sipas procedurave kushtetuese dhe parlamentare, si dhe pikës II të vendimit nr. 96/2014 “Për krijimin e Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën në sistemin e drejtësisë”, Komisioni i Posaçëm ka për detyrë vetëm: “Propozimin për miratimin e një pakete të plotë projektligjesh të nevojshme për reformimin e legjisllacionit, që rregullon organizimin dhe funksionimin e institucioneve të sistemit të drejtësisë, përfshirë ato kushtetuese, e hartuar me kontributin dhe me mbështetjen e institucioneve të sistemit të drejtësisë, të ekspertëve vendas dhe ndërkombëtarë, të subjekteve të tjera të interesuara dhe të opinionit publik”.

Pra, qartësisht detyra jonë është hartimi i draftit që do t’i propozohet për shqyrtim dhe miratim Kuvendit të Shqipërisë. Në këtë pikë, sjellim në vëmendjen tuaj se drafti i hartuar nga ne duhet të ndjekë më pas rrugën kushtetuese, të parashikuar në nenin 177 të Kushtetutës, si dhe shqyrtimit e miratimit sipas neneve 77/a dhe 77/b të Rregullores së Kuvendit, duke qenë se edhe amendamentet kushtetuese parashikojnë që procedura e miratimit të ligjit rishikues të Kushtetutës ka vlerë të posaçme dhe i nënshtrohet kontrollit të mëvonshëm të Gjykatës Kushtetuese. Në këtë kuptim, Komisioni i Posaçëm dhe Kuvendi duhet t’u qëndrojnë strikt procedurave kushtetuese dhe parlamentare standarde për miratimin e ndryshimeve kushtetuese.

Përfundimisht, ne mbështesim në parim ndërhyrjet dhe përmirësimet e bëra nga ekspertët e EURALIUS-it dhe të OPDAT-it në draftin kushtetues. Japim pëlqimin tonë në parim për paketën e ndryshimeve kushtetuese, por ky pëlqim nuk duhet të interpretohet kurrsesi me pranimin e çështjeve politike pandryshuara nga ana e ekspertëve në draftin kushtetues, siç është çështja e emërimit të funksionarëve me tre të pestat dhe çështja e skemës institucionale, të cilat unë i citova më sipër, dhe që duhet të diskutohen nën për nen, duhet të miratohen dhe t’i jepet pëlqimi gjatë votimit në tërësi. Në përfundim të fjalës, për dokument parlamentar, dorëzojmë të gjithë qëndrimin me shkrim të dokumentit të firmosur, të cilin sapo e lexova.

Faleminderit!

**Fatmir Xhafaj** – Faleminderit, zoti Halimi!

Vazhdojmë me diskutime të tjera në parim. Kush e do fjalën?

Fjalën e ka zoti Majko.

**Pandeli Majko** – Ne sot jemi në vazhdim të diskutimit të nisur mbledhjen e kaluar lidhur me votimin në parim të draftit të paraqitur nga ekspertiza ndërkombëtare bashkë me ekspertët shqiptarë, për të cilët kam fjalët më të mira Nuk ka rëndësi nëse është grupi i ekspertëve të maxhorancës apo i opozitës, sepse në çdo rast ata mbeten ekspertë. Mendoj se është një gjë shumë e mirë që diskutimi po orientohet në linjat e ekspertizës. Sigurisht, jo vetëm unë, por të gjithë kolegët e maxhorancës do të mbeten të hapur të diskutojnë hap pas hapi, nën pasqyrë, të gjitha problemet që shfaqen si rezerva, të cilat do t'i quaja të bazuara mbi një lloj ekspertize dhe jo mbi një lloj politike të caktuar, sepse nuk mendoj se mund të na ndajë politikisht një mënyrë votimi. Pra, në t'i diskutojmë të gjitha problematikat hap pas hapi, nën pasqyrë, sigurisht duke pasur edhe përkrahjen e ekspertëve që kemi pasur deri tani, qofshin ata të huaj apo ndërkombëtarë. Padyshim që e vlerësoj shumë ripërsëritjen e shqetësimit të përfaqësuesve të opozitës lidhur me idenë apo frikën se mund të krijohet korporatizëm.

Së pari mendoj se më keq se ç'është, nuk ka për t'u bërë, dhe, së dyti, ideja se mënyra e votimit do të na largojë nga anëtarë të këtyre institucioneve të reja, citoj “anëtarë respektivë”, mund të krijojë pakte të heshtura, mosmulumimi ndaj njëri-tjetrit. Mendoj se momente të caktuara ekstreme të subjektivitetit njerëzor, në nuk mund t'i ngremë në nivelin e diskutimit të parimit kushtetues. Ta marrim këtë subjektivizëm njerëzor dhe të përpiqemi ta përkthejmë në një parim kushtetues.

Së dyti, mendoj se çështja e votimit me 3/5 apo 2/3, ka një diskutim ekspertize. Në një vend ku Presidenti i Republikës zgjidhet me 50% plus 1 të votave në afatin e fundit, mendoj se ky President do të ndjehej i stresuar nga pikëpamja kushtetuese, ndërkohë që institucionet e tjera, nën vëzhgimin e tij, do të zgjidheshin me 2/3. Kjo për arsye të një trajtimi të caktuar politik apo subjektivist që ne sot po diskutojmë. Ndaj, mendoj se duhet të jemi të qartë me gjithë piramidën e shtetit kur diskutojmë çështjen e 2/3 apo 3/5, duke e parë në një pamje më të gjerë sesa interesat e një diskutimi rutinë apo ekspertësh pjesën e reformës në drejtësi që mbulon komisioni ynë.

Duam apo nuk duam, të gjitha problematikat apo mënyrat e sistemit të votimeve në vazhdim, kur të diskutohen, mendoj se duhet t'i orientojmë bazuar mbi të gjithë pikturën e Kushtetutës dhe jo vetëm të pjesës së pikturës që po diskutojmë.

Së fundi, pritjes sonë, më në fund i erdhi fundi, në kuptimin pozitiv e kam fjalën, ndaj propozoj të fillojmë të votojmë në parim, dhe më pas të vazhdojmë programin duke filluar

diskutimin nen për nen. Rast pas rasti, duke diskutuar problematikat në vazhdim, sigurisht do të ndajmë me kolegët vlerësimet tona, të cilat shpresoj të bazohen në opinionin e ekspertizës dhe jo në opinionin e politikës.

Faleminderit!

**Fatmir Xhafaj** - Faleminderit, zoti Majko!

Fjalën e ka zoti Mediu.

**Fatmir Mediu** – Të falënderoj, zoti Xhafaj!

Dua të vlerësoj dhe falënderoj ekspertët e OPDAT-it, EURALIUS-it dhe të gjithë ekspertët që kanë punuar deri tani me këtë draft, që na vjen në një moment reflektimi të përbashkët, që pa dyshim duhet të shoqërohet me një analizë më të thellë nen për nen.

S'mund të shtoj asgjë përfundimit që lexoi zoti Halimi, që ne si opozitë e miratojmë në parim këtë draft që na keni sjellë, dhe këtë miratim ne e bëjmë me seriozitetin maksimal duke analizuar të gjithë draftin që ju përcollët, me bindjen se ekspertët tanë po ashtu kanë sjellë vlerësime dhe shqetësime, të cilat i vlejné punës së këtij komisioni nen për nen, për të bërë të mundur që të kemi një sistem të pavarur dhe funksional duke shmangur kontrollin politik dhe korporatizmin, dhe në mënyrë të veçantë funksionalitetin e pushtetit gjyqësor.

Pa dyshim që zgjedhjet politike, ju vetë i keni rekomanduar apo shënuar, janë në dorë të politikës. Dua ta theksoj këtu, meqë zoti Majko ngriti çështjen e zgjedhjeve me 2/3 apo 3/5, që opozita nuk është as për 2/3 apo 3/5, por është për zbatimin e rekomandimeve të Komisionit të Venecias. Zbatimi i rekomandimeve të Komisionit të Venecias është shkruar e zezë mbi të bardhë, ku thotë sesi ne duhet të gjejmë marrëveshjen politike. Sikurse shprehu dhe zoti Halimi në materialin e vet, ne tashmë e kemi bërë marrëveshjen tonë bazuar në rekomandimet e Komisionit të Venecias. Gjithashtu, kemi rënë dakord për mënyrën se si duhet të operojmë dhe ta gjejmë këtë zgjidhje edhe në faktorin ndërkombëtar. Uroj dhe shpresoj që ky të jetë dhe qëndrimi i maxhorancës.

Pra, marrëveshja politike ngelet tashmë në qëndrimin dhe në shprehjen tuaj në zbatim të rekomandimit të Venecias apo të opsionit që është ofruar në bashkëpunim me OPDAT-in, EURALIS-in, që në muajin shkurt, sikurse e tha zoti Halimi.

Faleminderit!

**Oerd Bylykbashi** - Zoti Kryetar, seanca e sotme pa dyshim është e rëndësishme dhe unë, gjithashtu, dëshiroj të falënderoj ekspertët ndërkombëtarë për kontributin e tyre.



Në këtë proces kaq të rëndësishëm, i mbetem asaj që thashë herën e kaluar, që ky komision, ky parlament duhet të ndjehet autori real i kësaj pakete kushtetuese. Ndihma e OPDAT-it dhe EURALIS-it është vërtet e vyer për të gjetur rrugën drejt amendamenteve kushtetuese, të cilat do të përbëjnë atë që do të na ngrejë kokën lart dhe jo të na turpërojë.

Nisur edhe nga ajo që përmendi kolegu Majko, një çështje shumë e rëndësishme, siç është ajo e votimit me shumicë të cilësuar, i cili bëri një paralelizëm me çështjen e Presidentit, i cili zgjidhet në fund fare me 50% plus 1, duhet thënë se kurrë në Republikën e Shqipërisë, Presidenti nuk është parashikuar nga Kushtetuta për t'u zgjedhur në mënyrë definitive vetëm me 3/5-at. Edhe më parë ka qenë me 50% plus 1 në raundin e vet të fundit të krizës. Besoj se është mirë për ne të heqim ato elemente, të cilat na turbullojnë gjykimin. Presidenti i Republikës nuk është pushtet, nuk është asnjëri nga tre pushtetet. Ai është kreu i shtetit me funksionin që e parashikon Kushtetuta, por drejtësia është një nga tre kolonat, e cila ndërvepron me legjislativin dhe ekzekutivin, jo me Presidentin. Presidenti nuk ndërvepron me asnjë prej këtyre. Merr pjesë në sistem, por nuk është pushtet më vete.

Për të mos u turbulluar ne në gjykimin tonë, besoj se çështja që ngriti zoti Halimi në ekspozenë e qëndrimit të Partisë Demokratike, qoftë në parim, qoftë për elemente të caktuara, duhet marrë në konsideratë me shumë kujdes.

Ne japim sot pëlqimin në parim, por kjo nuk do të thotë se kjo prekludon diskutimin thelbësor për ato çështje politike të pazgjidhura, të cilat nuk mund të kalojnë me shpejtësi për të mbyllur çështjet nëpërmjet votimit nen për nen, sepse janë çështje themelore të pazgjidhura, dhe pa u zgjidhur ato, sistemi nuk qëndron. Nuk do të lemë diçka që do të na bëjë neve nder dhe lehtësojë jetën e shqiptarëve.

Çështja e 3/5 ose shumicës së cilësuar, në bindjen time solide, është përkeqësuar për shkak të faktit që kemi një sistem si ai që thotë Komisioni i Venecias në raportin e tij. Raporti thotë që kemi një sistem të rënduar, kompleks dhe vendimmarrje komplekse, sepse kemi brenda shumë institucione që ndërveprojnë me njëra-tjetrën me qëllim fisnik, si shmangien e korporatizmit, luftën kundër korrupsionit, por, nga ana tjetër, siç e thotë Komisioni Venecias mund të çojë në vendimmarrje komplekse, për rrjedhojë do të na ngatërrohet nëpër këmbë vet sistemi. Kështu që, për çështjen që ne ngremë në parim për thjeshtimin e sistemit, aty ku është e mundur, pa hequr asgjë nga objektivat që duhet të ketë kjo reformë, unë besoj që do ta gjejmë

gjuhën e përbashkët. Duhet mendje e hapur, vullnet pozitiv, dhe durimin për ta bërë shpejt. Padurimi nuk nxiton, por vetëm sa e vonon atë.

Fragmentimi, në gjykimin tim, ka sjellë më shumë politikë në sistemin e drejtësisë. Maxhoranca, në gjykimin tonë, kishte për qëllim që të krijonte sa më shumë vatra për kapjen e sistemit nëpërmjet shumicës së cilësuar që zotëron, dhe për ta çimentuar atë në të ardhmen. Nuk është një qëllim i shëndetshëm dhe nuk e ndihmon sistemin, por e bën më keq.

Do t'i japim mundësinë politikës, madje asaj të fortës që quhet "ekzekutiv", që të bëjë atë që quhet *forum shopping*, të peshkojë midis institucioneve tashmë të zvogëluara të sistemit të drejtësisë, për të parë ku janë pikat e pushtetit dhe të vendimmarrjes, të cilat mund të ndikojnë nëpërmjet emërimit me shumicë të cilësuar, nëpërmjet bllokimit të emërimit me shumicë të cilësuar etj., nëpërmjet presionesh, të brendshëm apo të jashtëm të sistemit, apo nëpërmjet instrumenteve të tjera.

E gjithë kjo e bën sistemin vulnerabël, ndaj duhet të kemi mendjen e hapur për të parë çfarë është ajo që në të vërtetë nuk na duhet dhe mund ta bëjmë ndryshe.

Besoj që nëpërmjet fragmentimit, rrezikojmë të bëjmë diçka që mund të jetë kundër produktive.

Sistemi i drejtësisë është menduar të jetë i pazgjydhshëm, i parinovueshëm periodikisht, vetëm e vetëm për t'i bërë ballë në mënyrë të pavarur dhe për të qenë garanti i fundit, jo vetëm i të drejtave të individëve, por edhe përballë autoritarizmit të të dyja pushteteve të tjera, sidomos pushtetit ekzekutiv. Nëse kjo kolonë është solide nga brenda, nuk është fragmentuar e tillë, që ta mbajë kolonën e pushtetit vazhdimisht në dridhje. Pse? Sepse institucionet e saj janë në përplasje të vazhdueshme, janë në konkurrencë të vazhdueshme për të krijuar pushtet me njëra-tjetrën dhe jo për t'i qëndruar kapjes politike që vjen nga jashtë dhe frenimit të autoritarizmit ekzekutiv, por edhe atij legjislativ. Nëse kjo ndodh, ky është një sistem, i cili nuk e ka egon për të qenë një pushtet që garanton drejtësi. Drejtësinë nuk e ka as legjislativi, as ekzekutivi, por e ka ky pushtet. Sigurisht, sa më shumë ndodh kjo, aq pak ndodh drejtësia e drejtpërdrejtë, e thjeshtë, transparente, efikase, pa korrupsion në shkallën e parë, dhe mundësisht vetëm atje të mbylleshin çështjet, sepse do të kuptohej që ka një problem që vjen nga koka.

Ne këtë ushtrim kaq të rëndësishëm duhet që këtij pushteti t'i japim autoritet të mjaftueshëm për t'i qëndruar presionit politik nga jashtë, si dhe, gjithashtu, për të krijuar autoritetin e organeve më të larta, si, për shembull, KLGJ-në apo KLP-në për të qenë më të afta

për të luftuar korporatizmin e brendshëm të sistemit, atë që do të prodhonte një inefikasitet apo problem tjetër. Korrupsionin do ta luftojmë me një instrument që po e fusim për herë të parë dhe kjo është shumë e rëndësishme, por nëse ne kemi institucione të vogla, të shumëfishta brenda një sistemi kaq të rëndësishëm, siç është sistemi i drejtësisë, kjo lloj egoje bie dhe ky lloj pushteti nuk e njih veten e tij për rolin që ka, për rrjedhojë mund të hyjë në krizë dhe mund të jetë më i kapshëm nga jashtë.

Sigurisht, ka një seri çështjesh të tjera për t'u diskutuar dhe besoj se edhe ekspertët ndërkombëtarë e dinë shumë mirë që ka nevojë për të ndërhyrë, siç janë shumë probleme të karakterit teknik.

Një tekst kushtetues nuk mund të jetë kurrë me kaq shumë probleme të draftimit, sepse e fusin në kolaps Gjykatën Kushtetuese dhe nuk e vë para dilemave se kë rrugë interpretimi të zgjedhë, por e kolapson interpretimin e dispozitës kushtetuese. Një presje, e thashë edhe herën e kaluar, mund të kushtojë një paragraf në një vendim gjykate. Besoj se me shumë punë intensive dhe me vullnet të përbashkët ne e mbyllim këtë çështje.

Së pari, siç tha edhe kolegu Halimi dhe kolegu Mediu, ne duhet të zgjidhim çështjet e rëndësishme, ndërkohë që jemi dakord të ecim përpara duke punuar mbi këtë draft.

Faleminderit!

**Fatmir Xhafaj** - Faleminderit, zoti Bylykbashi!

Zoti Vasili!

**Petrit Vasili** - Do të përpiqem ta përmbledh fjalën time.

Dua të them dy gjëra: në radhë të parë, ne sot kemi edhe një zhvillim tjetër, ku në tavolinën e punës kemi një qëndrim të opozitës, për të cilën jemi njohur më parë dhe patëm fatin ta ndjekim në mënyrë më të artikuluar edhe nga paraqitja e zotit Halimi.

I kemi shumë të qarta pikat ku kemi materie për të debatuar, por njëkohësisht kemi edhe një qasje në pikëpamje parimore se ku mund të ecim përpara. Besoj se sot kemi një pamje shumë më të qartë të çështjes falë kontributit shumë të rëndësishëm (në mënyrë të veçantë në materialin e opozitës dalin qartë disa momente, për të cilat ka përgjigje shteruese), kjo falë punës së vyer që ekspertët e EURALIUS-it dhe OPDAT-it kanë bërë. Besoj se kemi ardhur në një moment të qartë, ku mund të ecim përpara në punë. Besoj se një dakordësi në parim sot do të kishte një rëndësi të madhe. Pra, një votim në parim do të kishte një rëndësi të madhe për një çështje të caktuar.

Këtu dua të ndalem me dy minuta. Të gjithë bashkë, në kritikë shumë të rreptë që i kemi bërë sistemit (nuk ka rëndësi mirë kemi bërë që e kemi kritikuar edhe kur e kemi kaluar masën), kemi evidentuar një sistem që ndodhet në emergjencë. Në këtë sistem në emergjencë (po vazhdoj të përdor metaforat e shëndetësisë, sepse shumë të tjerë i kanë përdorur ndonjëherë edhe pa vend, por unë do t'i përdor pak me saktësi), një i sëmurë nuk mund të mbahet me vite në emergjencë dhe kjo gjë duhet të jetë e qartë për të gjithë. Pra, kjo emergjencë e ka një fund. Kritika e sistemit është bërë gjerë e gjatë, anët e sistemit janë bërë, të gjitha janë bërë, e kemi çuar në reanimacion, por nuk mund ta mbajmë reanimacion një vit. Kështu, praktikisht ne sot duhet të kemi një qëndrim, i cili përfundimisht duhet t'i japë mesazhin opinionit publik.

Ambasadori amerikan tha: “91% e shqiptarëve kanë një qasje që drejtësia duhet të ndryshojë”. Jam plotësisht dakord. Tani këta 91% e shqiptarëve presin një mesazh dhe nuk presin që ne të vazhdojmë të diskutojmë më tej dhe më tej, sepse unë nuk dua të jem bashkëfajtor i këtyre, të cilët nuk duan ta zgjidhin çështjen. Unë jam i mendimit që ne duhet të jemi të gjithë bashkautorë për ta zgjidhur çështjen.

Kështu, duke e dhënë të qartë qëndrimin politik të përbashkët që ne e miratojmë në parim një draft, i cili ka pësuar, sikurse e bashkëndajmë të dy krahët, përmirësime të rëndësishme, që do të evidentohen qartësisht jo vetëm nga ekspertët, por edhe nga këqyrja që opozita i ka bërë, kjo nuk na pengon dhe është legjitim debati për çështje të tjera.

Besoj se asnjëri këtu nuk pretendon se duke e votuar çështjen në parim, ne do t'i shterojmë apo do t'i mbyllim debatet. Absolutisht jo, por ama do të japim mesazhin që çështja u shtrua për zgjidhje dhe zgjidhja filloi të veprojë. Besoj se të gjithë do të kuptojnë se ajo çfarë ka ikur, ka qenë një kohë e gjatë, por ajo që na pret dhe që do të na çojë drejt zgjidhjes është një kohë shumë e shkurtër dhe do të na japë edhe zgjidhjen përfundimtare.

Kështu që duke qëndruar pikërisht në këtë çështje, besoj se mund të transferojmë një pjesë të mirë të debatit për çështje akoma më konkrete, ku disa çështje janë adresuar edhe në materialin e opozitës. Besoj se duke e votuar çështjen do të qasemi në mbledhje të tjera të radhës, që do të kemi në axhendën e përbashkët që do të miratojmë, por që nga sot duhet ta japim të qartë idenë se çështja ka hyrë në proces, në rrugën e zgjidhjes përfundimtare.

Ideja se do të vazhdojmë ta mbajmë problemin pezull, të jeni të bindur që nuk ndihmon asnjërin nga ne, përveçse rëndon situatën për opinionin publik, por edhe sistemin gjyqësor,

sepse, siç e thashë, është një sistem i mbajtur në tension, në agoni, i cili është i detyruar ndërkohë edhe të punojë, ndaj nuk mund të funksionojnë në këtë mënyrë.

Operacionet që do të bëjmë, kirurgjia kushtetuese që ne kërkojmë të ndërmarrim duhet të funksionojë, sepse nuk mund të jetë një ngjarje e mbetur në tentativë. Kështu që unë mendoj që ne sot të procedojmë me një votim në parim dhe sigurisht të miratojmë po sot, nëse është e mundur, edhe axhendën e komisionit për çështjet e tjera.

**Fatmir Xhafaj** - Faleminderit, zoti Vasili!

Kush e do fjalën?

Po, zoti Ristani.

**Arben Ristani** - Kam diçka të vogël dhe shumë të thjeshtë. Ajo që kemi vënë re është se kur çështjet fillojnë të zgjidhen, edhe dakordësia më pas është më e thjeshtë për t'u arritur. Nga të gjitha gjërat që kemi thënë deri tani duket qartë se të gjithë jemi dakord që në parim do të na duhet të bëjmë një reformë të sistemit të drejtësisë, për këtë do të na duhet të bëjmë një ndryshim kushtetues dhe të jemi gjithë dakord në parim ta bëjmë.

Kemi një pikë që me sa duket është më e nxehta për momentin, e cila ka të bëjë me pjesëmarrjen substanciale të opozitës. Pjesëmarrja substanciale e opozitës është një faktor i gjithëpranuar nga publiku shqiptar, nga politika shqiptare, nga partnerët tanë ndërkombëtarë dhe nga Komisioni i Venecias. Pra, që ta zgjidhim çështjen duhet pjesëmarrja substanciale e opozitës. Fakti që kemi sot është që votimi me 3/5-at në parlament nuk e siguron pjesëmarrjen substanciale të opozitës. Do të gjejmë një mekanizëm dhe me sa kam dijeni është bërë një bisedë midis faktorëve ndërkombëtarë dhe palëve politike, ndaj, me të arritur edhe këtë pjesë, kam besim se çdo gjë tjetër do të ecë shumë mirë. Ndërkohë ekspertët, por edhe ne kemi punuar gjatë me draftin dhe do të gjejmë jam i bindur një dakordësi, që do të na shkurtojë kohën dhe do të na japë një produkt shumë të mirë.

Faleminderit!

**Fatmir Xhafaj** - Faleminderit, zoti Ristani!

Zonja Hysi.

**Vasilika Hysi** - Faleminderit, zoti kryetar!

Kërkoj ndjesë, pasi do të bëj një diskutim ndryshe nga kolegët e mi.

Në mbledhjen e kaluar ne diskutuam lidhur me projektin që na vunë në dispozicion ekspertët e EURALIUS-it dhe të OPDAT-it, ku u diskutua edhe me ambasadorët për të bërë një

votim në parim. Kolegët e opozitës kërkuan kohë dhe thanë ta linin për ditën e hënë, pasi donin të njiheshin me projektin. Kur erdha sot në mbledhje mendova se do të zbatonim pikërisht ato procedura që përcakton Rregullorja e Kuvendit lidhur me funksionimin e komisioneve parlamentare. Duke qenë se komisioni ynë është një komision i posaçëm, i ngritur me vendim të Kuvendit, në bazë të Rregullores së Kuvendit, konkretisht neni 24, paragrafi 4, edhe ky komision u nënshtrohet rregullave të funksionimit, si komisionet e përhershme parlamentare, mendova se do të bënim pyetje, diskutime në parim dhe votimin në parim, për t'i hapur rrugë më pas diskutimit nen për nen dhe kalimit të projektit në seancë plenare. Në fakt, nga diskutimi i kolegëve të opozitës, por edhe nga materiali që na është vënë në dispozicion, nuk po arrij të kuptoj nëse duhet të kalojmë tani në miratimin në parim dhe më pas të diskutojmë nen për nen për një sërë pyetjesh dhe çështjesh, që sipas kolegëve kanë ngelur të pasqaruara.

Konkretisht janë katër çështje, të cilat me këtë diskutim na kthejnë në fillim të debatit, konkretisht me 3/5-at apo me 2/3-at, ruajtja e mandateve, korporativizmi, kahet politike të sistemit, si edhe disa probleme të tjera që lidhen me ILDKPKI-në, me dispozitat kalimtare e të tjerë.

Ky proces ka filluar që prej 6 muajsh, në nëntor të vitit 2014, është një proces gjithëpërfshirës, me një numër shumë të madh të ekspertëve vendas dhe të huaj që po shumohet, ndërkohë po kthehem në disa pika, për të cilat kemi marrë shumë përgjigje. Më vjen mirë që edhe analiza e bërë nga kolegët e opozitës ka nxjerrë në pah se projekti që ne duhet të miratojmë sot në parim ka 39 përmirësime: 12 vlerësime pozitive të paketa antikorrupsion dhe 23 vlerësime për organizimin e institucioneve.

Nga ana tjetër, kur thuhet që ne duhet të jemi të vëmendshëm për të luftuar këto katër momente të rëndësishme para se ta miratojmë këtë draft dhe, nga ana tjetër, na tërhiqet vëmendja se si duhet të punojmë apo që opozita është pjesë substanciale, duket se kjo bisedë nuk ia vlen midis nesh. Mund të thuhej kohë më parë, por jo për ne që ju kemi pritur kaq gjatë, megjithëse erdhët me një vit vonesë. Të shumtën e pyetjeve ne ua kemi adresuar ekspertëve, qoftë EURALIUS-it, qoftë të OPDAT-it, ku morëm përgjigje. Vetë ju theksoni dhe ne theksojmë se janë bërë shumë përmirësime. Ndaj, dua të them: duke qenë se jemi një komision që u nënshtrohemi rregullave të Rregullores, të kalojmë në miratimin në parim të projektit dhe më pas ta kalojmë me vëmendje nen për nen çdo dispozitë që kemi këtu. Pa dyshim në diskutimin nen për nen kemi të drejtë t'u ngremë pyetje ekspertëve, kemi të drejtë të diskutojmë, kemi të drejtë

edhe të adresojmë shqetësime, qoftë të teknikës legislative apo nëse keni pyetje, që ju mund t'i ngrini për materialin që është paraqitur, por të fillojmë të bëjmë këtë lloj diskutimi përsëri, mendoj se është një humbje e madhe kohe. Mendoj se ne kemi humbur plot 16 muaj kohë, sepse ekspertët kanë punuar dhe nuk e çmoj të dobishme që ne të vazhdojmë të diskutojmë këto çështje që janë thënë dhe stërthënë.

Unë kam këtë merak, sepse nuk dua të jem pjesë e përsëritjes së diskutimeve, por dua që të diskutojmë nen për nen dhe të jemi profesionistë sa më të mirë, në mënyrë që kur të mbeten dokumentet, ata që do të duan t'i interpretojnë më pas ndryshimet kushtetuese t'i kenë të qarta qëndrimet dhe atë çfarë ne kemi dashur të themi me këto ndryshime që po diskutojmë dhe që do të miratohen në parlament.

Faleminderit!

**Fatmir Xhafaj** - Faleminderit!

**Gent Strazimiri** – E para, të themi disa të vërteta që do t'i themi përsëri: nuk keni pritur asnjë sekondë që ne të vinim, e keni vazhduar punën vetë, bëtë edhe për draftin, që pastaj ra, ra prapë, ra prapë dhe ngeli ky draft. Parimisht, në qoftë se do të bëjmë retorikë, humbasim kohë, mendoj unë. Të thuash se 91% e shqiptarëve e duan reformën dhe, o burra, shpejt ta bëjmë, unë nuk kam asgjë kundër, por është po ashtu e vërtetë, që 99,9% e shqiptarëve nuk e dinë çfarë po bëjmë ne këtu. U kemi thënë se do të bëjmë reformën. Sigurisht, të gjithë do të thonë: bravo ju qoftë! Por 99,9%, përfshi edhe Kryeministrin, deri edhe para 11 orësh nuk e dinin çfarë po bënin, nuk e kanë lexuar. Për pjesën tjetër që nuk e kupton, po jua them: në mbledhjen e fundit që ishim këtu, 50% e anëtarëve të këtij komisioni, në mënyrë eksplicite thanë: “As na intereson ta lexojmë”. O burra, t'i japim lajmin e mirë popullit, ta votojmë, pa e lexuar, sepse, sigurisht, me konsideratë të lartë, ekspertët janë menduar mirë, janë të pagabueshëm. Thamë të gjithë, që me gjithë konsideratën për ekspertët, të ulemi ta shikojmë edhe ne një herë, sepse 99% e shqiptarëve presin dhe nuk e dinë çfarë do të bëjmë!

*(Ndërhyrje pa mikrofon).*

Ne nuk mund t'u themi se as ne nuk e kemi lexuar. Dhe bëme mirë që e bëme kështu.

I kemi thënë të tëra, por kjo ishte risi, këtë nuk e thoni ju. Personalisht, njësoj siç e tha zoti Halimi dhe siç e thanë të gjithë kolegët e tjerë, edhe unë shprehem dakord në parim, duke shtuar diçka më shumë nga ajo që zoti Halimi tha, nga ajo që zoti Bylykbashi argumentoi dhe nga ajo që pati merak zoti Ristani. Në këtë dokument parlamentar, që ne sot miratojmë në parim,

unë besoj se gjithçka që ne shprehëm si shqetësim është e pasqyruar në shënimin më sipër dhe më lejoni ta citoj. Është e shkruar jo e zeza mbi të bardhë, e kuqe mbi të bardhë, por sërish është e shkruar: “Këto propozime nuk përfshijnë ndonjë vendimmarrje politike, që nuk është arritur ende dhe as nuk kanë për synim të kërkojnë përzgjedhjen/favorizimin e një vendimi politik kundrejt një tjetri. Bazuar mbi këtë rezervë dhe mbi këtë parim, ashtu siç ju thanë edhe kolegët, ne sigurisht, do të japim votën tonë.

Faleminderit!

**Fatmir Xhafaj** – Faleminderit edhe për votën pro!

Ka diskutime të tjera? Nuk ka.

Më takon edhe mua t’i them dy-tri vlerësime për momentin në të cilin jemi, duke çmuar dhe ndarë të njëjtin besim me të gjithë kolegët, sepse ky është një moment vendimtar i procesit, është kurorëzim i rreth 20 muajve punë intensive që janë bërë në këtë parlament përmes një procesi gjithëpërfshirës, transparent dhe me garantimin e standardeve më të mira ndërkombëtare të fushës.

Pa dyshim, mund të ketë pasur dhe do të vazhdojë të ketë komente dhe këndvështrime të ndryshme, por një gjë është e padiskutueshme: procesi i realizuar në këta 20 muaj në këtë parlament është një nga ndërmarrjet më të mëdha parlamentare dhe një proces i pangjashëm më parë. Kjo është meritë e kontributit të jashtëzakonshëm të ekspertëve më të mirë vendas që kanë sjellë institucionet e sistemit për t’i përfaqësuar në këtë proces, rezultat i përfshirjes së të gjitha institucioneve të sistemit të drejtësisë gjatë këtij debati në mënyrë shumë aktive, por, gjithashtu, është edhe fryt i angazhimit dhe punës aktive të ekspertëve më të mirë ndërkombëtarë që ne kemi të atashuar në vendin tonë për procesin e asistencës dhe monitorimit të kësaj reforme, ekspertizë që nuk ka qenë, siç e kam theksuar edhe një herë tjetër, në rolin e këshilltarit të dhënies së opinionëve, por e përfshirë aktivisht në hartimin e produktit. Pra, sot kemi një proces që është kontribut i shumë aktorëve vendas dhe ndërkombëtarë, kemi një projekt që është bashkëpronësi e autoriteteve shqiptare, e ekspertizës më të mirë shqiptare, por edhe e kontributit aktiv të partnerëve dhe ekspertizës më të mirë të tyre në këtë proces.

Mendoj se, pavarësisht diferencave që kemi, ne duhet të jemi krenarë për këtë gjë, sepse nuk kemi bërë një ndryshim kushtetues brenda 24 orëve, as brenda 24 ditëve, por për muaj e muaj të tërë, duke filluar nga analiza e gjendjes që ka sot sistemi, te përcaktimi i qëllimeve, i objektivave tashmë për ndryshimin e tij në projektin konkret, në projektin kushtetues dhe në



rreth 40 projektligje, që do ta shoqërojnë këtë projekt kushtetues për ta ndryshuar në mënyrë thelbësore sistemin. Nuk gaboj aspak nëse them: për t'ju dhënë shqiptarëve një sistem të ri drejtësie, për të themeluar një sistem të ri drejtësie, për të themeluar drejtësinë e nevojshme të munguar për shqiptarët. Kjo është një ndërmarrje e jashtëzakonshme, që duhet të na bëjë të përgjegjshëm për këtë rol, për këtë mision, për këtë përgjegjësi, të vetëdijshëm për çfarë jemi duke bërë dhe, natyrisht, fort të angazhuar për ta kurorëzuar me sukses këtë proces historik.

Unë e vlerësoj përfshirjen e opozitës në këtë proces. Ne kemi bërë gjithçka për ta pasur opozitën në këtë tryezë dhe meqenëse disa nga kolegët e opozitës e cekën këtë çështje, paksa me civizëm, por është normale të ndodhë në debatet parlamentare, dua t'ju kujtoj disa momente. Megjithëse opozita hyri me vonesë në gjithë këtë proces, ne pranuan dhe e konsideruam të nevojshme për t'i dhënë mundësinë për të pasur paritet në përbërjen e këtij komisioni. Megjithëse të gjitha komisionet e mëparshme kanë qenë, edhe për projektet kushtetuese në këtë parlament, në përputhje me konfigurimin parlamentar, opozita ka pasur të përfshirë, në mënyrë permanente, ekspertët e saj në projektin kushtetues. Ekspertët e opozitës kanë qenë pjesë aktive e gupeve të punës dhe debateve. Opozita vetë, por në mënyrë të veçantë, përfaqësuesit më të lartë të opozitës këtu, kanë qenë pjesë aktive e gjithë procesit të debatit profesional dhe konsultimit publik, duke luajtur një rol aktiv në këtë proces. Ekspertë të opozitës janë të angazhuar në të gjitha grupet e punës që po punojnë për projektligjet, për jetësimin e këtij projekti kushtetues dhe për projektligjet që do ta shoqërojnë këtë projekt.

Opozita kërkoi që kjo fazë përmbyllëse t'u besohet jo më edhe ekspertëve vendas, por vetëm ekspertëve ndërkombëtarë, dhe ne jemi dakord me këtë gjë, e vlerësuam dhe kjo është arsyeja që sot, në këtë fazë të procesit, me vullnetin dhe dashamirësinë maksimale të partnerëve, rolin e ekspertit po e bëjnë thjesht dhe vetëm dy ekspertët e nderuar ndërkombëtarë, me një kontribut të rëndësishëm në këtë proces, kontribut, të cilin në vazhdimësi e kam përshëndetur dhe e kam vlerësuar me sinqeritet dhe pa asnjë fije hipokrizie për të qenë formalisht në rregull në marrëdhëniet me partnerët. Pra, edhe gjatë gjithë kësaj kohe, natyrisht, kemi pasur vonesa për shkaqe që dihen, sepse ne nuk kemi dashur të bëjmë asnjë vendimmarrje pa praninë dhe pa rolin aktiv të opozitës, sepse e konsiderojmë të rëndësishëm votimin gjithëpërfshirës në parlament, në mënyrë që të kemi një produkt sa më të qëndrueshëm në kohë.

Tani është momenti për hapin final: diskutimi dhe miratimi i projektit kushtetues dhe paraqitja në Kuvend për shqyrtim dhe miratim. Është konsumuar gjithë kjo kohë, është dhënë e

gjithë hapësira e nevojshme për hartimin e këtij projekti, për debatin e tij, konsultimit për të, trajtimit të rezervave, komenteve dhe pyetjeve, që kemi pasur jashtë dhe brenda kësaj sale. Tani kemi arritur në një moment deciziv, hapin e parë të së cilit e kemi hedhur sot me votimin në parim që do t'i bëjmë projektit.

Kemi një projekt kushtetues, e paraqitëm jo një herë, por dy herë në Komisionin e Venecias dhe bëmë mirë. Morëm një opinion final, ramë dakord, për efekt të besimit, të nevojës për të qenë të paanshëm në këtë proces, që reflektimin e këtyre rekomandimeve të opinionit final të Komisionit të Venecias ta bëjnë përfaqësuesit e OPDAT-it dhe të EURALIUS-it. U ngritëm atyre, gjithashtu, disa pyetje për lexime të ndryshme që i bënim opinionit të Komisionit të Venecias dhe ata me shumë seriozitet punuan dhe na sollën këndvështrimin e tyre, zgjidhjet e tyre për rekomandimet e opinionit final të Komisionit të Venecias, duke i pasqyruar ato qartazi në projektin bazë që është hartuar dhe më pas duke përfshirë, gjithashtu, edhe përgjigjet dhe reagimet që ata kanë ndaj pyetjeve të ngritura nga ana jonë për leximin që u kemi bërë çështjeve të caktuara. Pra, kemi një projekt kushtetues të punuar nga korriku i vitit të kaluar deri më sot për gati 9 muaj, një projekt kushtetues, që është hartuar nga ekspertët më të mirë vendas dhe ndërkombëtarë në një proces gjithëpërfshirës, ku janë reflektuar edhe rekomandimet finale, edhe këndvështrimet tona dhe tani ka ardhur momenti për ta votuar. Sot ne do ta votojmë në parim.

Unë e kam lexuar me vëmendje, të jem i sinqertë, dokumentin e paraqitur nga Partia Demokratike, edhe leximin që i bëri sot kolegu Halimi atij dokumenti, e kam parë me kujdes edhe thirrjen që i është bërë maxhorancës për sinqeritet në këtë proces. Shpresoj fort që kjo kërkesë të vijë nga një analizë e sinqertë e kolegëve të mi të opozitës dhe mbi të gjitha, mbi të gjitha, nga një vullnet i sinqertë, gjithashtu. Jam dakord për vlerësimin që i është bërë punës së ekspertëve në rishikimin final dhe do të kisha dashur një vlerësim të sinqertë për punën e bërë për gjithë këto muaj nga të gjithë ekspertët, grupet e interesit të angazhuara në këtë proces, por gjithsesi, edhe vlerësimi për ekspertët ndërkombëtarë, për dorën finalen që i dhanë ata këtij projekti, është sërish pozitiv.

Jam dakord për qëndrimin që keni mbajtur lidhur me nenin 25 dhe nevojën që ka për të ndryshuar, për të mos pasur kufizim kohor, apo kufizim në subjekte, që është pozitivisht racionale dhe qëndrim i përbashkët, dhe e konsideroj që në këtë moment një nen të ndryshuar. E vlerësoj, gjithashtu, këndvështrimin pozitiv të opozitës për risitë e këtij projekti, një sërë risish janë vendosur këtu. Opozita ka thënë që këto risi janë të miat. Dakord, nuk ka problem, sepse

nuk do të ndajmë të kujt janë. Nuk ka rëndësi fare. Rëndësi ka që ky është një dokument me shumë risi pozitive. Kjo është një gjë shumë pozitive. Sepse deri para pak muajsh çfarë nuk thuhej për këtë projekt. Çfarë nuk është më thënë mua personalisht dhe çfarë nuk është thënë publikisht për këtë projekt. Por sot shikoj se biem të gjithë dakord që ky është një projekt që ka shumë risi pozitive dhe kjo meriton përshëndetje.

Nga ana tjetër mendoj se nuk më duket shumë korrekte që flasim për një rol shumë aktiv për një kontribut aktiv të ekspertëve ndërkombëtarë për vlerësim për punën e tyre, dhe ne themi që ka edhe disa çështje teknike. A u dhamë mandat ne atyre për çështjet teknike? A na thanë ata që nuk ka çështje teknike. Ky është këndvështrimi ynë për çështje teknike. Besoj se kjo duhet të jetë e mjaftueshme për të thënë që nuk ka çështje teknike. Se ne prandaj ua kemi dhënë mandatin, prandaj i vlerësojmë, ndryshe ky vlerësim që mund të bëjmë për ta na rezulton hipokrizi. Pa dyshim që ka nevojë për çështje që mund të jenë të hapura, që kanë nevojë për vendimmarrje politike. Po, dakord jam, e kemi bërë këtë debat.

Dihet dhe pozicioni që ne kemi për këtë çështje. E kemi thënë dhe këtu dhe kjo nuk ka asnjë kundërshtim. Gjatë shqyrtimit përkatës çështjet që lidhen me shumicat, me formatimin e institucioneve, janë çështje për vendimmarrje politike. Kjo nuk ka diskutim. Ne nuk kërkojmë t'i rikthehemi këtij qëndrimi. Ky është një qëndrim që ne kemi mbajtur. Çështjet e tjera për ne janë në mënyrë të sinqertë me zgjidhjet e dhëna. Kurse kjo është një çështje që mbetet ende e diskutueshme dhe mund ta diskutojmë, mund ta lëmë me 3/5-at, si të doni ju. Mund ta bëjmë ndryshe, por hajde ta diskutojmë.

Natyrisht unë jua kam thënë qëndrimin tim dhe nuk mund të pranoj që oktapodi i PS-së të bëhet qengj kur ndahet me PD-në. Edhe oktapod, edhe qengj nuk mund të rri e njëjta figurë. Ndajeni mendjen. Kur është PD-ja, nuk është qengj dhe kur është PS-ja, është oktapod. Gjithsesi, ky është një opinion, të jem i sinqertë, unë e kam thënë. Jam konsistent në këtë gjë.

Ky është një opinion që do t'i qëndroj, por kjo nuk do të thotë që, siç ju nuk jeni për 3/5-at ne nuk jemi për këtë, nuk ka zgjidhje të tjera. Ka zgjidhje të tjera dhe ne duhet t'i gjejmë bashkërisht Mjafton të jetë vullneti i sinqertë për të ecur përpara. Pra, vullneti i sinqertë në vlerësim të punës që është bërë duke arritur në këtë produkt final, vullneti i sinqertë në vlerësim të të gjithë këtij procesi, vullneti i sinqertë dhe shprehja e sinqertë për partnerët dhe angazhimin e tyre përmes ekspertizës, si dhe për vetë këtë tavolinë. Me siguri shumë shpejt do të kemi edhe një produkt konkret. Sot mbasi kemi folur të gjithë votojmë në parim dhe votimi në parim është

një, pro dhe kundër. Mund të ketë edhe abstenime, por do të duhet ta ngremë dorën sot. Nesër do të fillojmë nen për nen. Si do të fillojmë? Propozimi im është ta ndajmë në 6 pjesë:

Pjesa e parë, nenet për integrimin, përfshirë dhe nenin 56, që është për bankën, meqenëse janë të një natyre. Pjesa e dytë, Gjykata Kushtetuese. Pjesa e tretë janë gjykatat. Pjesa e katërt institucionet, siç janë, inspektorati, tribunali, këshilli i emërimeve. Pjesa e pestë, prokuroria. Dhe pjesa e gjashtë dispozitat kalimtare, ku përfshihet edhe vettingu.

Pra, propozimi është ky. E ndajmë në 6 pjesë dhe nga një pjesë çdo ditë, shqyrtimin nen për nen dhe pastaj votimin në tërësi. Me vullnetin e sinqertë të të gjitha palëve dhe me atë çfarë kam kuptuar unë nga dokumenti juaj, jam shumë i bindur që ne do të mbarojmë shpejt. Dua t'ju ftoj për ta votuar në parim dhe për ta mbështetur këtë kalendar serioz dhe intensiv pune.

Po, zoti Halimi e ka fjalën. Në respekt të punës së madhe që keni bërë këtë fundjavë, meritoni të flisni.

**Eduard Halimi** – Në fakt unë mendoj se glorifikimi i këtij momenti, glorifikimi i ditës së sotme është i panevojshëm. Është e nevojshme që të tregohemi edhe seriozë, edhe të matur, por edhe modestia nuk na e prish punën tonë. Do të vijë dhe momenti i glorifikimit të procesit që do të jetë për çdo deputet, që është votimi në tërësi në parlament bashkë me paketën. Ai është momenti ku ne mund të shpërndajmë meritat, por ndoshta mund ta lëmë dhe pak modestinë.

Mendoj se momenti i sotëm nuk është as historik, as edhe procedural. Pse? Unë në fakt kam lexuar nja 10 vjet procesverbalet e hartimit të Kushtetutës, Pandit, por dhe të tjerët që kanë folur atëherë. Unë e kam thënë dhe në parlament gjatë kohës kur ke thënë këtë gjë në mbledhje, Pandi, dhe e kam vlerësuar këtë gjë. Unë besoj se edhe ata që do të vijnë mbas nesh do t'i lexojnë këto gjëra që i themi këtu, prandaj dhe i themi. Në këtë proces duhet të tregojmë maturi. Edhe para 3 ditësh kur këtu erdhi drafti dhe nuk e kishte lexuar asnjëri dhe ju bërtisni të gjithë se mbaroi reforma, hajdeni ta miratojmë. Unë besoj se qëndrimi i opozitës ishte i matur. Ne duhet të jemi të matur. Nëse dikush do ta lexonte këtë procesverbal mbas disa kohësh, do të thoshte këta deputetët tanë, si e votuan kështu pa e lexuar, pa i hedhur një sy?

Unë besoj se ajo që duhet të reflektojmë duhet të jetë matura në këtë proces, në mënyrë që procesi të vijojë të japë edhe produktin që ne presim. Momenti që është sot, momenti politik, e them këtë dhe për arsye të rekordeve të atyre që na lexojnë, prandaj dhe them që nuk është dhe procedural, sepse ne biem dakord për gjëra që nuk biem dakord, siç e thotë lideri juaj suprem. Pra, ne biem dakord që të mos biem dakord për emërimet e institucioneve, apo me 3/5-at, apo për

sa u përket formulave. Lidhur me shumicën e cilësuar ne e kemi mbyllur këtë histori. Ne kemi rënë dakord me partnerët ndërkombëtarë me formulat. Ne biem dakord me Komisionin e Venecias, topin e keni ju. Doni Venecian, doni ekspertët, si të doni. Nuk e doni, ky është procesi. Ky moment duhet të jetë moment maturie. Prandaj i kemi shënuar të gjitha në dokumentin tonë dhe i lexuam edhe këtu. Edhe duke lexuar nenin 177 të Kushtetutës, edhe nenet e Rregullores, që ata që do të vijnë pas nesh, kur ta lexojnë të mos thonë që këta që kanë qenë nuk dinin të lexonin as Rregulloren dhe as Kushtetutën. Por këta e bënë punën e tyre, u treguan të matur me procesin.

Ndaj, në përfundim, sot vota jonë është qëndrimi ynë politik dhe është një votë pro për të ecur përpara me diskutimet nen për nen të amendamenteve kushtetuese për të gjitha çështjet teknike që ekspertët e OPDAT-it dhe EURALIUS-it kanë parashtruar në dokumentin e datës 4 maj. Dhe ashtu siç u diskutua dhe u tha pak më përpara nga zoti Xhafaj, vota jonë pro, vota politike, nuk duhet të interpretohet si një votë pro për çështjet politike për të cilat ne duhet të vazhdojmë diskutimin. Për opozitën ky proces ka përfunduar, formula e prezantuar nga ekspertët ndërkombëtarë, formula e prezantuar nga Venecia. E votoni Venecian, thoni kur edhe Venecia mund të jetë e gabueshme, siç thatë për ekspertët. Kjo është çështja juaj, edhe për ne kjo çështje politike do të jetë në diskutim.

Sa për procesin pastaj nuk dua t'i shtoj më as nota të tjera se si ka shkuar, sepse e kemi bërë tërkuzë në këtë komision. Por e vërteta është që 37 çështjet, faktet, flasin vetë, janë thënë te ky dokumenti këtu që në shtator. Dhe që atëherë do ta kishim përfunduar edhe këtë procesin e miratimit. Ndaj për ta mbyllur, vota jonë politike sot është votë pro për diskutimin me amendamente, por nuk duhet të interpretohet kurrë, dhe nuk duhet të merret kurrë si një votë e cila ka të bëjë me çështjet politike për të cilat ekspertët nuk janë shprehur dhe palët kanë akoma vend për të diskutuar. Faleminderit!

**Fatmir Xhafaj** – Dakord. Erdhi momenti për ta përmbyllur diskutimin, thjesht për të bërë votimin në parim të projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8417, datë 21.10.1998 Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar.

Kush është dakord në parim me projektligjin? Kundër? Nuk ka.

Miratohet.

Faleminderit përkthyesve! Faleminderit edhe bashkëpunëtorëve tanë këtu, miqve partnerë dhe ekspertëve ndërkombëtarë që asistuan!

Nesër do t'ju njoftojmë për orën e mbledhjes për diskutimin e kapitullit të parë, siç ramë dakord. Kjo në varësi të angazhimit të ekspertëve dhe mbledhjeve të grupeve parlamentare. Besoj se do të jetë pasdite vonë.

Mbledhja mbyllet.

**MBYLLET MBLEDHJA**